E martë, 11 korrik 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

[I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, mund të thërrisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mirëmëngjesi. Do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04337. Vërej që z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi janë të pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit, ndërsa z. Krasniqi po na ndjek me videolidhje, me lejen që i është miratuar.

Jemi gati të vazhdojmë.

Sekretare, sillni dëshmitarin brenda në sallën e gjyqit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes, Dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë jeni?

DËSHMITARI: Po, ju lutem. Mirëmëngjes, zotëri.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëgjoni mirë?

DËSHMITARI: Po, z. Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë me dëshminë tuaj sot. Ju kujtoj t'u përgjigjeni pyetjeve që ju drejtojnë me përgjigje të qarta, të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni avokatit ta përsërisë pyetjen ose thoni thjesht që nuk e kuptoni dhe ta sqarojmë pyetjen për ju. Por theksoj që është shumë e rëndësishme ta dëgjoni fillimisht pyetjen dhe pastaj t'i përgjigjeni.

Po ashtu na thoni ku e keni bazën e dijenisë suaj për faktet dhe rrethanat për të cilat ju do të përgjigjeni.

Jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën sikurse lexuat dje në deklaratën solemne.

Mos harroni që të flisni para mikrofonit, prisni pesë sekonda para se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë në mënyrë që dhe përkthyesit të kenë mundësi ta përkthejnë.

Nëse keni nevojë për ndonjë pushim, na njoftoni dhe ne do t'ua plotësojmë këtë kërkesë.

Kur të jepni dëshmi, shihni dhe Trupin Gjykues përballë, sepse kur ngre unë dorën, unë dua që të ndalosh së foluri sepse dua të jap një udhëzim.

E kuptoni këtë?

DËSHMITARI: Po, z. Gjykatës. Vetëm një sqarim ma lejon? Nëse nuk ka mundësi me mbajt gjithë sytë drejt se më lotojnë, kur të gjithë për ata nuk forcë me të shiqu gjithë, pra, do të mundohem. Do të mundohem dhe do të respektojë urdhrin e juaj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Vetëm kaq kërkojmë dhe ne. Faleminderit.

Dhe vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtja e Selimit, pastaj Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Veselit dhe në fund Mbrojtja e Krasniqit.

Avokati i z. Selimi, z. Roberts do të marrë fjalën tani dhe do të vazhdoj me pyetjet e veta.

Z. Roberts, fjala është për ju.

Pyetje të palës tjetër nga Z. Roberts:

Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

PË. Mirëmëngjes, z. Avokat

PY. Ju kujtoj që jemi në seancë publike.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Në fakt, do ju lutesha të kalonim në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund ta nxirrni dëshmitarin nga salla e gjyqit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë gjë tjetër?

Në rregull. Kam përshtypjen që bëri një gabim të vogël sepse ai tha që ai e qëlloi me armë zjarri gruan dhe motrën. Kështu që duhet që ta sqarojmë këtë gjë kur të kthehet.

Z. PACE: [Përkthim] Pra, është e mundur që për arsye planifikimi të mund të kemi një vlerësim të kohës që do i duhet ekipeve të Mbrojtjes për t'i bërë pyetje dëshmitarit?

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Deri tani besoj se 10 minuta ose më pak se kaq, po megjithatë do të duhet të presim të shohim çfarë përgjigjesh të tjera do japë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

Z. ELLIS: [Përkthim] Dhjetë deri në 15 minuta, jo më shumë se kaq, 20 minuta maksimumi.

Z. MISETIC: [Përkthim] Do të përpiqem që të përfundoj në pak sesa një orë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Në rregull. Atëherë do bëjmë pushim deri në orën 11.30.

--- Pauza fillon në orën 11.02

--- Seanca rifillon në orën 11.31

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni.

Sekretare, mund të sillni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur,

të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në seancë publike. Ndërkohë që jemi në seancë publike Mbrojtësi i Viktimave ka dorëzuar një kërkesë për kundërpyetjen për Dëshmitarin 4746. E marrim parasysh këtë gjë dhe do t'ju japim fjalën për t'u bërë pyetjet pasi të mbarojë Prokuroria.

Z. Laws, faleminderit.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, jemi gati që të vazhdojmë me dëshmitë tuaj para Trupit Gjykues. Do t'ju kërkojmë që të lexoni betimin solemn të dëshmitarit.

Ju lutem lexojeni betimin që sapo iu dha. Ju lutem lexoni me zë të lartë dhe më pas do ju pyes në qoftë se i pranoni ato çfarë lexuat.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë time dhe përgjegjësisë time ligjore deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W04746

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e kuptoni betimin që sapo lexuat?

DËSHMITARI: Po e kuptoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A i pranoni këto që lexuat?

DËSHMITARI: I pranoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem uluni.

Dëshmitar, jemi gati që të fillojmë me dëshminë tuaj përpara Trupit Gjykues. Sikurse e dini Prokuroria do të jetë e para që do t'ju bëjë pyetje. Pastaj do t'ju bëjë pyetje Mbrojtësi i Viktimave dhe pasi të përfundojë Mbrojtësi i Viktimave do t'ju bëjnë pyetje ekipet e Mbrojtjes të të akuzuarve. Gjithashtu do t'ju bëjë pyetje anëtarë të Trupit Gjykues.

Prokuroria ka vlerësuar 12 orë për t'ju marrë në pyetje. Ndërkohë që Mbrojtjet për të akuzuarit parashikojnë 23 orë për t'ju bërë pyetje. Dhe një orë parashikohet nga Mbrojtësi i Viktimave. Shpresojmë që palët të jenë të kursyera në kohën e përdorur. Dhe shpresojmë që të përdorin të gjithë kushtet e nevojshme për një proces të drejtë.

Ju lutem dëshmitar, përgjigjuni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen na thoni që ta përsërisim përsëri pyetjen ose thojini për shembull palës që ju bën pyetjen që nuk e kuptoni pyetjen dhe ata do t’jua formulojnë ndryshe. Po ashtu ju lutem na thoni se çfarë baze ka njohuria e fakteve apo rrethanave për të cilat do të jepni dëshmi.

Në qoftë se ZPS-ja ju kërkon që të thoni apo të vërtetoni disa korrigjime në deklaratën tuaj, keni parasysh që

deklaratat e shkruara së bashku me korrigjimet duhet që të konfirmohen prej jush që reflektojnë plotësisht dhe saktësisht deklaratat tuaja.

Ju lutem flisni para mikrofonit. Bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara sesa të jepni përgjigjen e pyetjes në mënyrë të tillë që t'i jepni kohë përkthyesve që të përkthejnë atë që do të thoni. Flisni ngadalë.

Ndërkohë që do të jepni dëshmi përpara kësaj gjykate, nuk lejohet që ju të jepni informacion lidhur me dëshminë e dhënë në sallën e gjyqit pasi të dilni nga salla e gjyqit. Në qoftë se dikush ju bën pyetje lidhur me gjëra që do të thoni në sallën e gjyqit pasi të dilni nga salla e gjyqit, ju lutem na e thoni këtë gjë.

Ju lutem në qoftë se shikoni se kam ngritur dorën ose në qoftë se ju kërkoj që të mos flisni më, ju lutem ndaloni së foluri sepse mund të kem udhëzime për t'ju dhënë.

Nëse keni nevojë për pushim gjatë kohës kur do të jepni deklaratë, ju lutem na e thoni lirisht këtë gjë, dhe ne do të mundohemi që t'jua plotësojmë kërkesën.

Do të fillojmë me marrjen në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

Pyetje nga znj. Lawson:

ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

PY. Mirëdita z. Mustafa. Jemi takuar për herë të parë shkurtimisht javën që shkoi. Unë do t'ju bëj disa pyetje në emër të Prokurorisë. Pyetjet do t'jua bëj gjatë ditës së sotme dhe ndoshta dhe nesër.
Nëse pyetjet që do t'ju bëj nuk janë të qarta për ju, ju lutem na e thoni këtë gjë dhe unë do të përpiqem në maksimum që t'jua bëj sa më të qarta dhe t'i shpreh ndryshe pyetjet. Është e rëndësishme që t'i dëgjoni pyetjet dhe t'i jepni përgjigje konkrete për pyetjen sepse sikurse e tha edhe kryegjykatësi kemi shumë pyetje për tu bërë. A e kuptuar se çfarë thashë deri tani?
PË. Po.
PY. Në rregull. Do të fillojmë me ca pyetje të përgjithshme. Ndërkohë jemi në seancë publike. Ju lutem a mund të na thoni emrin dhe mbiemrin e plotë për procesverbal?
PË. Jam Rrustem Mustafa.
PY. Kur keni lindur?
PË. 27.02.1971.
PY. A ju janë drejtuar ndonjëherë me ndonjë nofkë, a keni pasur ndonjë nofkë ndonjëherë?
PË. Po, gjatë luftës isha si Remi.
PY. A keni qenë pjesëtar i UÇK-së?
PË. Po, kam qenë.
PY. Kësaj çështjeje do t'i kthehemi në më shumë hollësi. Por, gjatë periudhës 1998 dhe 1999 çfarë titulli konkret apo çfarë

pozite konkrete keni pasur brenda UÇK-së?
PË. Kam qenë nga ushtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri te pozita e komandantit të zonës operative të Llapit.
PY. A është e saktë se ju keni dhënë deklarata të tjera të mëparshme dhe keni dhënë intervista të ndryshme dhe deklarata të ndryshme përpara UNMIK-ut, EULEX-it gjithashtu?
PË. Deklaratat të cilat kanë pasur të bëjnë me procesin që është kanë kundër meje gjatë kohës së UNMIK-ut dhe të EULEX-it si dhe deklaratat para gjykatës dhënë para tri vitesh, para Gjykatës Speciale.
PY. Faleminderit. Do të jap disa hollësi të tjera të lidhura me këtë për një çast. Keni dhënë një intervistë në vitin 2002. Ka pasur një proces gjyqësor në vitin 2003, ka pasur përsëritje të proceseve gjyqësore në vitin 2009 dhe 2013 dhe një proces apeli ose një çështje që është dërguar në Gjykatë Apeli në vitin 2015. A është e saktë se nëse në secilin prej këtyre rasteve ju keni dhënë deklaratë përpara Gjykatës?
PË. Kam dhënë deklaratë dhe kam folur gjatë të gjithë procesit që është udhëhequr kundër meje.
PY. Në janar të 2019 ju gjithashtu i keni dhënë një deklaratë Zyrës së Prokurorit të Specializuar, a është e saktë kjo?
PË. Po.
PY. A keni pasur mundësi që të lexonit deklaratat që keni dhënë më herët javën që shkoi?
PË. Po. Ju më keni ofruar t'i shoh disa pjesë të deklaratave

të mia dhënë para Gjykatës.
PY. Deklaratat që keni rishikuar a ishin të sakta, apo keni për të bërë ndonjë korrigjim lidhur me to?
PË. Unë me sa kam parë nuk kam pasë ndonjë ndërhyrje, nuk kam pasë pse të ndërhyj, pse të mendoj ndryshe.
PY. Faleminderit. Me shumë gjasa do të përmendim disa prej deklaratave të mëhershme që keni dhënë ju gjatë marrjes në pyetje prej Prokurorisë. Ju përmendët zonën operative të Llapit para pak çaste. Ju lutem a mund të përshkruani zonën gjeografike që mbulonte zonën operative të Llapit?
PË. Zona operative e Llapit përfshin regjionin e Prishtinës, Podujevën, Prishtinën, Obiliqin dhe Fushë-Kosovën.
PY. Kur ka ndodhur beteja e parë frontale në të cilën keni marrë pjesë ju si pjesë e zonës së Llapit?
PË. Në shtator 1998, me 15 shtator.
PY. Në çfarë vendi ka ndodhur beteja?
PË. Është vendi mes Mitrovicës dhe Podujevës i quajtur Kaçandoll.
PY. Dëshiroj t'ju tregoj një dokument që mban datën e shtatorit 1998.
ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca për këtë dokument është P00156 dhe versioni në gjuhën angleze të këtij dokumenti është P00156-ET.
PY. Ju lutem z. Mustafa, a mund t'i hidhni një sy këtij dokumenti, a e dini çfarë është ky dokument?

PË. Po, është pjesë e një shkrimi nga gazeta ditore për luftën çlirimtare gjegjësisht për betejën që lidhet edhe me betejat e shtatorit.
PY. A e keni lexuar më herët këtë artikull gazete ose këtë komunikatë që reflekton artikulli i gazetës?
PË. Është artikull i vjetër nuk më kujtohet. Unë jam munduar me i përcjellë të gjitha lajmet në atë kohë, por nuk besoj që ja kam arritur të gjitha.
PY. Nëse lexoni paragrafin e katërt në versionin në shqip fillon në fjalinë e fundit te kolona, dhe ka të bëjë me luftimet në zonën e Llapit. Kjo është ajo beteja që po na përshkruarit pak çaste më herët?
PË. Po.
PY. Më pas erdhi një periudhë kur pati armëpushim?
PË. Po.
PY. Kur ka ndodhur kjo?
PË. Nuk më kujtohet me saktësi po është tetori dikund. Ka evidenca që janë publike pas ardhjes së OSBE-së në Kosovë.
PY. Tetor të vitit 1998, kështu?
PË. Po.
PY. Sapo përmendët ardhjen e OSBE-së. Çfarë qëllimi kishte, pse erdhi OSBE-ja në atë kohë?
PË. Mendoj vëzhgimin që po zhvillohej në Kosovë dhe ndërmjetësimin e luftës mes dy palëve.
PY. Dëshiroj t'ju tregoj një tjetër dokument.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00228827. Dhe versioni në gjuhën angleze është me të njëjtën numër reference po përfundon me ET në fund.

PY. Ju lutem a lexoni pak datën në fund të dokumentit?

PË. Po.

PY. A mund ta lexoni me zë, duhet ta kisha thënë unë në fakt pyetjen. A mund ta lexoni me zë datën që është në fund të dokumentit?

PË. 19.11.1998, Prishtinë.

PY. A e njihni nënshkrimin që mban ky dokument?

PË. Po, e njoh.

PY. I kujt është ky nënshkrim?

PË. Dihet që kjo është i zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nëse do të shikojmë dokumentin në fillim.

PY. Besoj që e shikoni që ky është një dokument i cili i është drejtuar zonave operative. A është e saktë kjo?

PË. Adresimi po shihet këtu që po.

PY. A ju kujtohet ky dokument?

PË. Unë po e shoh tani si dokument i mirë, por nuk më kujtohet.

PY. Do të shohim përmbajtjen e dokumentit për një çast. Është një dokument që i jep udhëzime, tregon sesi duhet të ndërveprohet me gazetarët, me vëzhguesit dhe me diplomatët. A

ju kujtohet të jenë dhënë udhëzime nga Shtabi i Përgjithshëm lidhur me këto çështje?

PË. Unë e lexova. Unë e di që është diskutuar brenda radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mirësjellja me vëzhgues, me gazetarë po edhe me gjithçka që komunikonte me luftën tonë, por dokumenti si dokument nuk po më kujtohet tani.

PY. Nëse do të shohim paragrafin e dytë të këtij dokumenti që ka të bëjë me vëzhguesit. Pra thuhet që Shtabi i Përgjithshëm ka caktuar personin i cili është i ngarkuar për informim të ndërsjelltë me vëzhguesit dhe se caktimi i këtij personi do të njoftohet me shkresë të veçantë. A ka ndodhur kjo gjë?

PË. As sot nuk e di kush ka qenë.

PY. Nuk ju kujtohet apo nuk e dini se kush ka qenë personi i ngarkuar në zonën operative të Llapit për të mbajtur marrëdhënie me vëzhguesit?

PË. Ah, për zonën operative të Llapit e kam caktuar unë. Unë e kam caktuar jo Shtabi i Përgjithshëm.

PY. Kush ishte ky personi që ke caktuar?

PË. Kam pasë te zyra për informim publik tre ose katër persona.

PY. Ju lutem a mund të na thoni sesi quheshin këto persona?

PË. Po. Ismet Sakiqi, Lirak Qelaj, Hysen Fazliu dhe eprorët e lartë të zonës në përgjithësi, shefi i shtabit, zëvendësi im dhe komandantët e brigadave.

PY. Do t'ju tregoj tani një tjetër dokument.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për referencë dokumenti në gjuhën shqipe është 099772. Dhe versioni në gjuhën angleze është U002-2849. Në qoftë se ju duhet numri i plotë i dokumentit ju lutem më thoni.

PY. Z. Mustafa të presim një çast sa të shfaqet dhe përkthimi në anglisht. Megjithatë, ndërkohë që shfaqet përkthimi në anglisht hidhini një sy dokumentit që keni në ekran.

Ju lutem lexojeni titullin me zë nëse është e mundur.

PË. "UÇK shtrirja e saj në terren dhe raporti me vëzhguesit e KDOM të OSBE-së."

PY. Faleminderit.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen e fundit të këtij dokumenti.

PY. Ju lutem përsëri, a mund ta lexoni datën në fund të dokumentit?

PË. Prishtinë, 19.11.1998.

PY. A e njihni nënshkrimin në këtë dokument?

PË. Është nënshkrimi i njëjtë.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të shohim përsëri faqen e parë të këtij dokumenti. Dhe uleni pak faqen, ju lutem. Faleminderit.

PY. A e shihni aty që Fatmir Humolli është përcaktuar si ndërlidhësi për zonën e Llapit?

PË. E shoh.

PY. A ju kujtohet që është bërë ky caktim?

PË. Jo, nuk më kujtohet. Po më duket është gabim.

PY. Ju nuk e dinit që ai ka pasur ndonjë rol për të luajtur në lidhje me OSBE-në?

PË. Është emri që më së paku është marrë me këtë çështje. Mund të jetë takuar, mund të jetë caktuar, por unë nuk e paskam ditur këtë gjë.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës po shoh orën, kështu që në qoftë se mendoni se është momenti i përshtatshëm mund të bëjmë pushimin e drekës tani.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

Dëshmitar, do të bëjmë pushimin e drekës tani. Ju kërkojmë ndjesë se nuk keni shumë që hytë në sallën e gjyqit megjithatë ne kemi orarin që bëjmë pushimin e drekës tani.

Do të bëjmë një pushim dreke për një orë e gjysmë dhe do të kthehemi në sallën e gjyqit në orën 2.30. mos harroni që nuk duhet të diskutoni me askënd lidhur me dëshminë që po jepni në sallën e gjyqit.

Sekretare, ju lutem shoqërojeni zotërinë jashtë sallës së gjyqit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, do të bëjmë pushim deri në 2.30.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të sillni dëshmitarin.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni.

Dëshmitar, do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Do të vazhdojë Prokuroria me pyetjet.

Znj. Prokurore, fjala është për ju.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit Gjykatës.

PY. Mirëdita, z. Mustafa.

PË. Mirëdita.

PY. Forcat serbe e respektuan marrëveshjen e armëpushimit që hyri në fuqi në tetor të ’98?

PË. Jo.

PY. E çfarë bënë ata që tregonte se ata e cenuan apo e shkelën këtë marrëveshje?

PË. Ata ishin të paligjshëm në vendin tonë. Çdo gjë që e bënin ata e cenonin marrëveshjen, e cenonin integritetin tonë. Luftonin forcat tona dhe popullatën e vendit. Dhe bënin gjithë atë represion mbi popullatën shqiptare.

PY. Pra, ata vazhduan me luftimet, pavarësisht se kishin një marrëveshje armëpushimi, këtë doni të thoni?

PË. Po.

PY. Nga nëntori i ’98-s, çfarë pozicioni gjeografik kishte UÇK-ja në zonën e Llapit. Pra, ku ishte vija e parë e

luftimeve, e frontit për ju?
PË. Për neve ishte vija e luftës nga Majaci; vija përreth Podujevës deri te fshatrat Bradash, Dobratin, përfshi edhe Llapashticën.
PY. Sa koha zgjati kjo vija, mbrojtje, kjo mbrojtja e kësaj zone?
PË. Deri pas përfshirjes të forcave të NATO-s në bombardimin e forcave armike.
ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do doja që të vendosnim në ekran një hartë. Është ERN SPOE00238091. Duhet ta zmadhojmë pak lart nga ana e djathtë. Kjo është zona që na nevojitet. Pak më shumë po ta zmadhoni do të ishte shumë mirë. Uleni edhe pak hartën që të shohim Dobratin.
PY. Z. Mustafa, e shihni Majacin në hartë, e gjeni dot Majacin në hartë dhe kur ta shihni do t'i kërkojmë ndihmë Sekretares së Gjykatës që ta qarkoni Majacin.
PË. Nuk po e gjej dot se e di se këtu duhet të jetë diku.
PY. Është në të majtë të vizës së kuqe që thotë, lexon "snake', kjo që lexon "snake", diku në të majtë besoj se është Majaci, në fund, ku takohen lumenjtë, këtu poshtë Sallabajës. Ku është viza e kuqe. Majac poshtë.
PË. Po.
PY. Faleminderit. Pra, shënojeni; shënjojeni Majacin.
PË. [Shënon]
PY. Tani bëni një vizë lart, na tregoni, pra, ku ka qenë vija

mbrojtëse, duke bërë me një vizë lart deri në Dobradov, Dobratin, më falni.

Në cilën anë të kësaj vije e kishit ju kontrollin, lindjen apo perëndimin? Cila anë?

PË. Kontroll efektive nuk kishte asnjëra anë, por perëndimin e synonim, ishim prezent.

PY. Ashtu, mund të shënoni, mund të vendosni numrin 1 përkrah kësaj vizës që sapo vizatuat; vendosni një 1-sh diku në krah.

PË. [Shënon]

PY. Po ashtu, mund të qarkoni fshatin Bajgorë, ju lutem?

PË. [Shënon]

PY. Aty vendosni numrin 2, ju lutem.

PË. [Shënon]

PY. Në qendër të vijës së mbrojtës shohim Llapashticën. Ky është fshati ku ishte e vendosur për një periudhë kohore shtabi i zonës së Llapit?

PË. Po.

PY. Pak a shumë në çfarë periudhe apo çfarë datash ishte i vendosur shtabi në këtë zonë?

PË. Ka evidenca besoj, edhe publike, por me sa po mendoj tani për tani nëntori, dhjetori, janari, shkurti e marsi.

PY. Bëhet fjalë nga tetori ’98 deri në marsin e ’99, kështu?

PË. Mundet. Ka edhe evidenca publike; mundet me qenë tetori.

PY. Mund të qarkoni këtë fshatin dhe t’i vendosni numrin 3, ju lutem.

PË. [Shënon]

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do doja që harta me shënimet përkatëse të pranohet si provë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtime?

Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Atëherë, materiali ERN SPOE00238091, pra, harta, pranohet si provë. Ju lutem, t'i vendosni numrin e provës materiale.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Harta me shënimet përkatëse merr numrin e provës materiale P00223.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

PY. Në fillim të dëshmisë thatë që keni qenë komandant i zonës operative të Llapit. A ka pasur anëtarët të tjerë komanda, linja komanduese e zonës së Llapit?

PË. Po.

PY. Do flasim për secilën nga pozicionet një për një. Një zëvendëskomandant e kishit?

PË. Po, ishte Kadri Kastrati.

PY. Po pseudonim kishte?

PË. Daja.

PY. Kush e caktoi z. Kastrati si zëvendëskomandant?

PË. Unë.

PY. Do doja t'i referoheshim intervistës, transkriptit të intervistës që keni pasur me Prokurorinë, me ZPS-në.

Do të jap edhe referencat për momentin. Do t'ju them që është pjesa 4 --

Z. ROBERTS: [Përkthim] E kundërshtoj. Ç'qëllim ka kjo ta lexojmë këtë? Po e riformuloj. Dëshmitari është shumë i qartë në përgjigje. Për çfarë duhet të shkojmë tani në deklaratën e tij? S'e kuptoj; e kundërshtoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Rrëzohet kundërshtimi. Vazhdoni znj. Prokurore.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është pjesa 4, faqja 13 për referencë.

PY. Aty thoni:

"E di që Kadri Kastrati u caktua nga Shtabi i Përgjithshëm".

A mund të na e shpjegoni këtë përgjigje?

PË. Varet si doni ta interpretoni. Unë kam caktuar, por Shtabi i Përgjithshëm e ka miratuar pozicionin tim, z. Kastrati dhe shumë pjesëtarëve të tjerë të komandës time janë bo, janë miratu më vonë nga Shtabi i Përgjithshëm.

Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar i Trupit Gjykues, për këtë pyetje nuk kemi probleme, por në të ardhmen do donim të dinim nëse deklarata do përdoret për çështje të pengimit të drejtësisë, sepse përndryshe rregulla 143 thuhet që kjo lloj

procedure duhet të bëhet pasi të japë miratimin Trupi Gjykues. Kështu që, duhet ta shpjegojmë paraprakisht për çfarë qëllimi do ta bëjnë apo do ta ndjekin këtë procedurë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

PY. Kadri Kastrati, kur ju bashkua, po, kur iu bashkua zonës operative të Llapit? Kur iu bashkëngjit?

PË. Besoj dikun në qershor të vitit 1998.

PY. Do doja t'ju tregoja një fragment të një libri "Lufta për Kosovën: Flet komandant Remi".

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në shqip është SPOE00330195 edhe do të shkojmë në faqen 330259. Në anglisht është SPOE00053263 edhe faqja është 53302.

PY. Ndërkohë që presim që të shfaqet në ekran materiali, unë mund t'ju pyes, z. Mustafa, a e njihni këtë libër?

PË. Po.

PY. Çfarë ka ky libër, për çfarë është?

PË. Është intervistë mbi ngjarjet e luftës.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E ngremë pak lart shqipen që të shohim mirë paragrafin e parë.

PY. Në këtë paragraf këtu, z. Mustafa, besoj se ju po përshkruani kohën kur Kadri Kastrati ishte caktuar në zonën e Llapit, kështu?

PË. Po.

PY. Është, i përshkruan siç duhet rrethanat apo ngjarjet e asaj kohe?
PË. Unë jam mundu t'i të jem korrekt me përshkrimin edhe në intervista publike.
PY. Domethënë, po, doni të thoni po?
PË. Po.
PY. Në fund të paragrafit flisni për ditën e parë kur erdhi Bislim Zyrapi në Likoc. E shihni, në fund? Dita e parë kur ka ardhë në Likoc Bislim Zyrapi.
PË. Po.
PY. Kjo është dita, pra, kjo është dita kur ka ardhur edhe Kadri Kastrati? Ka ardhur dhe është caktuar në zonën e Llapit, kjo ditë është?
PË. Po, këta kishin ardhur bashkërisht. Një grup oficerësh kanë ardhur bashkërisht dhe Kadri Kastrati ka udhëtuar bashkë me ta.
PY. Kush erdhi tjetër me Bislim Zyrapin atë ditë?
PË. Kanë qenë 5-6 oficerë eprorë. Nuk më kujtohen detajet, por e di që unë kam pas qëllim për me shkue me kontaktue Kadri Kastratin për me e sjellë me vete në zonën time.
PY. Po tjetër kush ka qenë i pranishëm në Likoc asokohe, në atë periudhë?
PË. Nuk më kujtohet.
PY. Cili ishte qëllimi i vizitës në Likoc?
PË. Qëllimi im ka qenë për me shku me marrë me vete Kadri

Kastratin.

PY. Flasim për shefin e kabinetit. Kishin një shef kabineti? Shef shtabi, më falni.

PË. Po.

PY. Si e kishte emrin?

PË. Nuredin Ibishi.

PY. Po nofkë a kishte?

PË. Leka.

PY. Kur është emëruar ai?

PË. Mendoj që menjëherë mbas ardhjes së Kadri Kastratit.

PY. Po përveç nofkës "Leka", kishte ndonjë nofkë tjetër?

PË. Jo. Unë nuk e di.

PY. Kush e emëroi atë?

PË. Znj. Prokurore, emërimet kanë mujt me i bo edhe Shtabi i Përgjithshëm, por vendimtar ka qenë mendimi im, se kush duhet të jesh shef, zëvendës dhe anëtar i komandës së zonës së Llapit. Për hir të oportunitetit, të bashkëpunimit me Shtabin e Përgjithshëm ka mujt me ardhë miratimi edhe nga ata.

PY. Kur thua, mund të bëhej edhe nga ata --

PË. -- miratimi --

PY. -- do të thuash që edhe ata mund të bënin, pra, dhe bënim miratime?

PË. Ata bënin miratime me kërkesën time. Ishte kohë kur po formësohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës; po mundoheshim sa më mirë të organizoheshim dhe ne bëheshim oportun me hierarkinë,

mundoheshim të bëheshim.
PY. Kujt i raportonte Nuredin Ibishi?
PË. Mua.
PY. Është e saktë të themi që ka pasur disa sektorë brenda komandës së zonës?
PË. Po.
PY. A të kujtohet cilët ishin këta sektorë?
PË. Po.
PY. Mund të na i thoni emrat dhe pastaj mund të flasim një për një për secilin? Si e kishin emrin secili sektor?
PË. Fatmir Humolli u tha më herët, Sejdi Rama, Latif Gashi, Muhamet Latifi, Avdi Kiqmari, Naser Ramadani dhe Hamit Hamiti.
PY. Pra, Ahmet Hamiti, Hamet, Hamet, Hamet Hamiti, për cilin sektor ishte përgjegjës? Çfarë sektori drejtonte?
PË. Logjistik, sektorin logjistik.
PY. Kishte nofkë?
PË. Secili nga ne kishte një nofkë. Tani s'po më kujtohet për Hamitin.
PY. Kujt i raportonte?
PË. Shefit të shtabit edhe ose mua drejtpërdrejt.
PY. Çfarë detyrash mbulonte sektori i logjistikës?
PË. Grumbullimin e të mirave logjistike për luftën në përgjithësi që ishin të nevojshme për ne. Mbartjen dhe shpërndarjen.
PY. Kur thua të mirat, mallrat e keni fjalën për pajisje,

uniforma, armë, domethënë për këto gjëra, këto sende?
PË. Ishin edhe gjërat që kishin të bëshin me ushqimin tonë edhe me të gjitha të mirat që duheshin, derivatet e gjithçka tjetër.
PY. Flasim për Fatmir Humollin. Po ai për cilin sektor ishte përgjegjës?
PË. Sektori për komunikim civil.
PY. Nofkë kishte?
PË. Basi.
PY. Kujt i raportonte?
PË. Shtabit të zonës. Domethënë, ishim tre eprorë që e drejtonin. Unë isha komandanti, Kadri Kastrati ishte zëvendësi dhe Nuredin Ibishi ishte shef shtabi.
PY. Po Latif Gashi, për cilin sektor ishte përgjegjës?
PË. Shef i Shërbimit për Informim.
PY. Nofkë a kishte?
PË. Lata.
PY. Po ndonjë nofkë tjetër kishte?
PË. Ka dalë një pseudonim që gjatë procesit është përmend, por mu gjatë luftës nuk më kujtohet ai pseudonim. Mirëpo, e di që është përmend mbas luftës.
PY. Si ishte ky pseudonim?
PË. Fati.
Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund të pyesësh ky përshkrimi dhe këto rolet, a mund, do t'i lutesha Prokurorisë sa herë që të

pyesë për këto detaje të pyesi edhe datën dhe periudhën kohore kur këta persona kanë qenë përgjegjës për këto role. Për të kuptuar nëse këto role përkojmë me aktakuzën.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, do ta bëjmë edhe këtë.

PY. Hamit Hamiti, çfarë date e mori rolin e logjistikave, si përgjegjës për logjistikën?

PË. Nuk jam i sigurt, por ende pa dalë publikisht si UÇK, se ishim nëpër shtëpitë tona për qytete, unë kisha nda rolet për secilin. Domethënë, në fillim të viteve ’98 edhe pse nuk kishim fare ushtarë, unë kisha caktuar mandatin e tyne, se cilat punë do t’i kryenin kur të dilnim në male, siç e themi ne atje.

PY. Fatmir Humolli, kur ka filluar që të mbajë këto përgjegjësi ose detyrat për çështjet civile? Rreth çfarë periudhe besoni ju ka qenë kjo?

PË. Fatmir Humolli ka përfaqësu një organizatë edhe ajo për çlirimin e Kosovës dhe kemi bërë marrëveshje ma vonë. Më duket që dikun tetor, nëntori i ’98.

PY. Të njëjtën pyetje e kam edhe për Latif Gashin. Kur i ka filluar detyrat e veta rolin e vet si pjesë e shërbimit për informim Latif Gashi?

PË. Mundet me ra që ky na ka ardhun ma vonë në mendje, por Latif Gashi ka qenë anëtarë i komandës qysh herët e ka qenë mik i imi. Mundet me konë në fillim, në fund fund të ’98, po mendo.

PY. Kush e ka caktuar atë?
PË. Unë.
PY. Kujt i raportonte ai?
PË. Shtabit të zonës që unë e udhëheqja. Unë isha komandant.
PY. Kur thua, shtabit të zonës, a mund të thuash konkretisht, të lutem, se kujt i raportonte ai, kujt brenda shtabit të zonës?
PË. Thashë, shtabin e zonë e udhëheqja unë, zëvendësi im dhe shefi i shtabit.
PY. Dhe ai u raportonte të tre juve, kështu?
PË. Mund të kërkonim informata nëse ai dinte, por jo vetëm nga ai po nga secili ne mund të kërkonim informata. Jo raport formal, por --
PY. Për sa kohë e keni njohur Latif Gashin?
PË. Njohja ime ka qenë e hershme. Por për UÇK-në punojmë bashkë nga ’97, fillimi i ’98 ndoshta.
PY. Nga ku e njihnit më përpara këtë person dhe si e njihnit më përpara?
PË. Nga aktiviteti politik i kohës.
PY. Si do e përshkruanit marrëdhëniet tuaj me të?
PË. Korrekt dhe njerëz që besonin në shoqin-shoqin edhe për punë si ato që po vinin ma vonë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.
PY. A e dini mesatarisht se sa vetë punonin për Latif Gashin në kuadrin e shërbimit për informim të zonës operative të

Llapit?

PË. Latif Gashi ka pas të drejtë të flasë me secilin por nuk ka pas rrjetin e konsoliduar. Ai ka pas Hyzri Tallin bashkëpunëtor kur ka qenë i angazhum për gjithë sipër organizimin e njësiteve të zonës operative të Llapit dhe ka, domethënë, ka kryer shumë punë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovë. Për të ishin të gjitha të rëndësishme.

PY. Kur thoni që ai ka pas të drejtë që të fliste me kë donte, me gjithkënd, këtu përfshinte dhe faktin që ai kishte mundësi që të bashkëpunonte edhe me njësite të tjera në zonën operative të Llapit për t'u ndihmuar prej tyre?

PË. Secili nga ne ka pas atë të drejtë. Domethënë, nuk ka pas kufizime kurrkush nga ne për të sjellë të mira për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

PY. Përmendët Hyzri Tallën dhe thatë që Hyzri Talla ishte bashkëpunëtor i Latif Gashit. A mund të na thoni se çfarë roli konkret kishte Hyzri Talla?

PË. Me ju thonë të drejtën, unë i kam llogaritun të dy gati njësoj. Thashë Hyzri Talla e ka lujt rolin si mbështetës për Latif Gashin. Merreni si të doni ka qenë pozita e tij, por Hyzri Talla ka qeni, kemi qenë duke u përgatit dhe kemi pas mendimin për me avancuar në zonë. Por ai u vra në një pritë dhe ra dëshmor.

PY. A do ishte e drejtë që ta përshkruanim Hyzri Tallën si zëvendësin e Latif Gashit?

PË. Po, mundemi edhe ashtu, ndoshta, por nuk besoj që Latif Gashi i ka thonë ndonjëherë bashkëpunëtor i tij zëvendës. S'ka pas strukturë për me e qujt zëvendës.

PY. Hyzri Talla a ka qenë ndonjëherë pjesëtar i shtabit të komandës së zonës?

PË. Ka qenë shumë afër meje dhe të gjithë këtyne të shtabit të përgjithshëm por anëtar nuk ka qenë.

PY. Do t'ju lexoj një fjali nga libri "Lufta për Kosovën: Flet Komandant Remi".

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk besoj se është e rëndësishme që të shfaqet në ekran. Megjithatë, do jap referencën, faqen e dokumentit. Pra, referenca e librit është SPOE00053263 dhe e kam fjalën konkretisht për faqen 53301.

PY. Në këtë faqe ju thoni:

"Unë isha komandant i zonës dhe Latif Gashi, Fatmir Humolli, Hyzri Talla, Sejdi Rama dhe Avdi Kiqmari ishin pjesë e shtabit". A është e saktë kjo?

PË. Po ka, kam mujt me e thonë edhe kështu.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj që të paraqesim një dokument tani. Është dokumenti me numër identifikimi P00151. Dhe dokumenti në gjuhën angleze është me të njëjtin numër por ka këtë ET në fund, -ET në fund. Faleminderit. Atëherë shohim faqen e parë. Ju lutemi, lexojeni me zë titullin, z. Mustafa.

PË. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Zona Operative e Llapit, Sektori për Moral dhe Politikë, mbi situatën aktuale politike,

kush ishte Hyzri Talla".

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem, a mund të kalojmë në faqen e fundit të këtij dokumenti?

PY. Të cilëve janë këto nënshkrimet në fund të kësaj faqeje, z. Mustafa?

PË. Tek komandanti i ZOLL-it jam unë; ky tjetri nuk më është i njohur. Mund të jetë i dikujt nga Zyrës për Informim Publik.

PY. A e njihni këtë dokument, e keni parë më përpara?

PË. Nuk më kujtohet, por unë e kuptoj rrethanat edhe situatën kur ka qenë dhe kemi lëshu ksi dokumentash shpesh për publik.

PY. Është një dokument që i referohet sektorit për moral dhe politikë. A ka qenë ky një sektor brenda zonë së Llapit?

PË. Po.

PY. Kush ishte drejtuesi i këtij sektori?

PË. Fatmir Humolli. E thamë edhe më para.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të kalojmë përsëri te faqja e parë e këtij dokumenti.

PY. A ju kujtohet se kur është nxjerrë ky dokument? Apo në çfarë rrethanash është nxjerrë ky dokument?

PË. Me rastin e vrasjes së dëshmorit Hyzri Talla. 11.12.1998. Ashtu siç shkruhet në dokument, besoj atë ditë është nxjerrë.

PY. Kujt i është shpërndarë ky material?

PË. Njësiteve tona dhe të gjithë atyne që kemi bashkëpunuar ne me ta. Por ma merr mendja, unë nuk po më kujtohet saktësisht tani.

PY. Si është shpërndarë ky material?
PË. Përmes njësiteve tona.
PY. Prodhimi apo shkrimi i materialeve të tilla të ngjashme me këtë që kemi përpara, a ishte pjesë e zakontë e sektorit për moral dhe politik?
PË. Tash, me sa po kujtoj tash, është pjesë e zakontë në zonën time, meqenëse organizata LKÇK ishte pranuar të strehohej tek ne. Ne bashkëpunonim ngushtë me të. Edhe ata kanë ndiku, kso, në materiale propagandistike.
PY. A ju kujtohet se në çfarë date është bërë kjo marrëveshja me LKÇK-në?
PË. Ka qenë, më duket se është fillimi i vitit 1998. Mundet me qenë janari, shkurti.
PY. Përmendët se Fatmir Humolli ishte përgjegjës për sektorin për moralin, kështu?
PË. Ka mund, ka mund të jetë edhe Valon Murati. Tash, tash po e, po këndellëm me LKÇK-në.
PY. Kur është caktuar ai, e kam fjalën për Fatmir Humollin; kur është caktuar Fatmir Humolli në sektorin për moralin?
PË. Fatmir Humolli ka qenë ashtu si e thamë më herët. Është tjetër sektor ky tani, për moral dhe politikë; është Valon Murati, Fatmir Humolli ka qenë në një sektor për marrëdhënie me publikun. Më falni që i kam ngatërrue sektorët.
PY. Do t'i kalojmë për një çast.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Megjithatë, për momentin mund t'i

heqim dokumentet nga ekrani.
PY. Përmendët Sejdi Ramën më herët. Në çfarë sektori punonte ai, për kë sektor ishte përgjegjës?
PË. Për informim publik.
PY. Kujt i raportonte ai?
PË. Njëjtë, njëjtë sikur gjithë sektorët, shtabit të zonës, ku komandant isha unë.
PY. A kishte ndonjë nofkë ai?
PË. Jo.
PY. Nuk kishte apo nuk të kujtohet apo nuk je në dijeni të kësaj, nuk e di?
PË. Sejdi Ramën e kam pas shumë afër; nuk ka pas. Jam i sigurt që nuk pas pseudonim.
PY. Çfarë detyrash kishte sektori për informim publik?
PË. Kryesisht punë në lidhje me media dhe televizione.
PY. A ishin të autorizuar ata që të nxjerrin deklarata në emër të zonës?
PË. Ishin të deklaruar me miratimin tim.
PY. Kush ishte tjetër i autorizuar që të nxirrte deklarata në emër të zonës?
PË. Edhe Valon Murati, kryetari, koma -- kryetari i sektorit për moral dhe politik, që e thamë më herët.
PY. Këto deklarata a kërkonin miratim prej jush?
PË. Mund edhe veç të njoftoheshim, unë, shefi i shtabit ose zëvendësi im.

PY. Zona e Llapit a kishte kontakte me shtypin e Kosovës?
PË. Po mendoni mediat e Kosovës?
PY. Nuk e kam fjalën konkretisht, domethënë, e kam për KosovaPress-in, në veçanti, nuk e kam për mediat në përgjithësi.
PË. Besoj që ka pas, por tash s'po më kujtohet. Jam i sigurt që kanë pas lidhje në numrat telefonit edhe mënyrat e komunikimit, unë besoj që ka pas. Por ka qenë të vështira.
PY. Pra, ju komunikonit me ta, për shembull, përmes telefonit?
PË. Po kanë mund, por nuk më kujtohet kjo punë, por kanë mund.
PY. Po me faks ose përmes mjeteve të tjera, keni mujt me komuniku?
PË. Nuk kemi pas.
PY. Çfarë lloj informacioni i jepnit atyre kryesisht?
PË. Me mediat në përgjithësi kanë punuar kësaja eprorë të zonës. Domethënë, ne kemi pas kryeqendrën afër, në Prishtinë dhe mediat kanë qenë shumë prezente afër nesh. Ne kemi punuar më shumë me mediat publike të asaj kohe, por edhe me të huajat.
PY. Pra, duke folur konkretisht për KosovaPress-in, KosovaPress-it juve ai i jepnit, për shembull, informacione ose përditësime për operacione të caktuara?
PË. Për operacione, për këtë nuk besoj. Nuk më kujtohet se ka

pas komunikim të veçantë, rrugë të veçantë për komunikim. Por e di që kanë qenë numrat e telefonit edhe kanë mund me komunikue, këto drejtori nërmes veti.

PY. Atëherë të flasim për Avdi Kiqmari, shefi i kujt sektori ishte ky?

PË. Sektorit për financa.

PY. A kishte nofkë ky?

PË. Qeli.

PY. Kujt i raportonte ai?

PË. Shtabit të zonës, njësoj sikur të tjerët.

PY. Kur është caktuar ai për të punuar për sektorin e financës?

PË. Edhe ky ka qenë ende pa dalë në mal, si e themi ne.

PY. E keni fjalën përafërsisht në periudhën e majit të 1998?

PË. Ka mund edhe më herët, janar ’98, shkurt, sa unë isha student në Prishtinë.

PY. Përmendët Muhamet Latifin, për kë sektor ishte përgjegjës Muhamet Latifi?

PË. Mbrojtje territoriale; mbrojtje civile i kemi thënë [e padëgjueshme].

PY. Për çfarë ishte përgjegjës ky sektor?

PË. Ishte për organizim të njerëzve dhe njësiteve jashtë vijës frontale të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ne synonim të ishim në çdo vend, në çdo fshat.

PY. Po ai edhe ky ju raportonte juve, zëvendësit tuaj dhe

shefit të shtabit, njësoj?
PË. Po.
PY. Besoj që personi tjetër që përmendët ishte Naser Ramadani. Për cilin sektor ishte përgjegjës Naser Ramadani?
PË. Sektorin e lidhjeve.
PY. A kishte nofkë ky?
PË. Jo, nuk ka pas, por s'po më kujtohet që ka pas tani.
PY. Edhe ai ju raportonte juve, zëvendësit tuaj dhe shefit të shtabit, kështu?
PË. Po.
PY. A ka pasur një sektor për personelin në zonën operative të Llapit?
PË. Këtu ka qenë, është konë, ka qenë i përgatitur për me ardhë Hyzri Talla. Nga, meqë Hyzri Talla kishte ra dëshmor, ne e kemi lënë vendin edhe s'e kemi mbulu asnjëherë.
PY. A kishte një sektor operacionesh?
PË. Jo.
PY. Kush ishte përgjegjës për çështje operative, për çështje funksionimi?
PË. Ka qenë zëvendësi dhe shefi i shtabit.
ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshiroj të shfaqet në ekran një dokument. Dokumenti mban numrin e identifikimit P00149. Versioni në gjuhën angleze ka të njëjtin numër, por ka pjesën ET në fund. A mund të shkojmë në faqen e fundit ju lutem.
PY. A e njihni nënshkrimin në fund të këtij dokumenti?

PË. Po.
PY. I kujt është ky nënshkrim?
PË. I imi.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të kalojmë te faqja e parë e dokumentit.

PY. A e keni parë më herët këtë dokument?
PË. Besoj se po. Nuk më kujtohet saktë, por e pranoj si dokument timin.
PY. Çfarë dokumenti është ky ose cili ishte qëllimi i këtij dokumenti?
PË. Për t'ju kujtuar njerëzve që ishin të vendosur atyre sektorëve, detyra dhe obligimet e tyre.
PY. Nga dolën këto rregulla?
PË. Shefi i shtabit, bashkë me zëvendësin tim dhe eprorë të tjerë, kishin një varg dokumentesh, një varg librash, literature ushtarake nga shteti shqiptar, por edhe ish-Jugosllavia dhe kishin përmbledh këto detyra dhe unë i kisha miratuar me urdhëresë. Siç e shihni edhe me emrin tim, tani mo publik. Kemi dashtë këto dokumente që t'i, i kemi [e pakuptueshme] me siguri edhe njerëzve për me qenë më të besueshëm. Mundet me qenë që ju ka dhonë edhe dikujt nga mediat, këto lloj dokumentesh. Kemi pas nevojë me paraqit Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës sa më të rregullt.
PY. Do ta bëj pyetjen më konkretisht. Rregullat ishin bazuar në ndonjë gjë, në një dokument që kishte dërguar shtabi i

përgjithshëm, shtabi, po, shtabi i përgjithshëm?
PË. Ka mund të ketë në mendje dikush edhe dokumente të shtabit të përgjithshëm të kohës. Por mu po më flet si dokument unik që e kanë ndërtue eprorët e mi. Eprorët e stafit tim.
PY. Kur thua, dhe mund të ketë qenë, a po pohoni që kështu ka qenë?
PË. Nëse e kanë lexu diçka, ndonjë rregullore apo letër nga shtabi i përgjithshëm, them mund të kenë marrë diçka nga ajo, por unë po e them, po e pranoj si dokument timin dhe stafit tim, që kanë mujt me marrë rregulla nga cilatdo burime që kanë mujt me i zënë.
ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do doja të tregoja një fragment të vogël të një transkripti të Prokurorisë dëshmitarit.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patët një deklaratë mospërputhëse më përpara. Pra, domethënë, keni një mospërputhje, këtë doni të thoni?
ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt, këtë doja të sqaroja edhe unë, për çfarë qëllimi ishte, për qëllime fajësimi apo për vërtetësinë e përmbajtjes?
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të jetë për të dyja.
ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca është pjesa 12; pjesa

12, më falni, faqja 16, kjo është për palët.
PY. Ju thoni:
"Pra, ky është një shpjegim për këto rregulla, sesi duhet të funksionojë sektori. Detyrat dhe përgjegjësitë e shtabit, e shefit të shtabit, dhe detyrat e përgjegjësitë e të gjithë të tjerëve. Pra, këto rregulla vijnë nga shtabi i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe u përshtatën për zonën që drejtoja unë. Po, mbase shtabi im e ka përgatitur dokumentin dhe unë e kam nënshkruar, kështu që është dokumenti im".
Kështu është? Është e saktë kjo që thamë?
PË. Po, nuk po shoh mospërputhje. Të njëjtat gjëra po i them edhe tani. Kanë mujt nga të gjitha burimet me u marrë këto deklarata, këto rregulla.
Z. MISETIC: [Përkthim] Unë nuk shoh ndonjë mospërputhje mes asaj që ka thënë në Gjykatë dhe mes asaj që lexoi Prokurorja.
ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, unë në fakt doja thjesht të sqaroja pyetjen që bëra pak më herët.
PY. Pra, ju po thoni që këto dokumente nuk kanë ardhur nga ndonjë burim tjetër, por këto rregulla janë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat u përshtatën më pas për zonën që drejtoja unë. Kështu?
PË. E nderuar Prokurore, kjo, ky dokument si burim ka mujt me u shfrytëzue edhe dihet, ka ardhtë nga shtabi i përgjithshëm. Nga literatura e ushtrisë shqiptare, por edhe e ish-

Jugosllavisë. Domethënë, është përmbledhja e rregullave dhe unë e kam nënshkruar për t'ju drejtuar sektorëve dhe njësiteve të mia në zonën operative të Llapit. Mundet edhe me ardhë nga shtabi i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës.

PY. Në fakt, kështu ka ndodhur. Ka qenë një nga burimet që keni përdorur.

PË. Sigurisht.

PY. Në faqen 1 të dokumentit, përmendet një urdhër sekret administrativ me datën 23 dhjetor 1998. Për çfarë ishte ky urdhër? Është poshtë titullit "Sektori i personelit", tek 5.

PË. Nuk më kujtohet, por me sa shoh unë është "sekret" në thonjëza.

PY. "Sekret" në thonjëza, a ka ndonjë kuptim në veçanti?

PË. Po mendoj që nuk ka qenë fare sekret. Qëllimi jonë, thashë, ka qenë për me vu, ndoshta edhe në publik këtë deklaratë. Unë nuk po jam i sigurt tani dhe kemi dëshirue që të të shihemi sa më të rregull e sa më të organizuar. Por nuk po më kujtohet pse është vu fjala "sekret". Vetëm ma tërhoqe vëmendjen pse është vu në thonjëza.

PY. E kuptoj.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic, kishin një koment?

Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, thjesht nuk po shihnim fundin e faqes, por u korrigjua, u rregullua kjo gjë.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim]
PY. Sa brigada kishte zona operative e Llapit?
PË. 3 brigada.
PY. Kur u krijua secila prej tyre?
PË. Njëra nga ato, e para, është krijuar në vitet, gjatë muajit korrik, mendoj, besoj, apo gusht; e dyta gjatë muajit shtator; ka fundi i vitit edhe e treta.
PY. Dhe për secilin nga këto raste e keni fjalën për vitin ' 98, kështu?
PË. Po.
PY. A kishin numra brigadat?
PË. Po.
PY. Çfarë numrash?
PË. 151, 152 dhe 153.
PY. Cilët ishin komandantët e secilës prej këtyre brigadave?
PË. Idriz Shabani ishte nga fillimi deri në fund, i brigadës 151. Brigada 152 ishin Nuredin Ibishi në fillim, pastaj Arif Muqolli vjen pas ti. Sejdi Veselli vjen në Brigadën 153, pastaj Adem Shehu.
PY. A ju kujtohet kur e mori Adem Shehu detyrën, pra, kur e mori Adem Shehu detyrën nga Sejdi Veseli?
PË. Nuk jam i sigurt.
PY. Pak a shumë, ju kujtohet kur Arif, kur e mori Arif Muqolli detyrën nga Nuredin Ibishi?
PË. Ariq Muqolli ka mujt me qenë në tetor ose nëntori i vitit

’98.

PY. Arif Muqolli kishte nofkë?

PË. Profa.

PY. Idriz Shabani kishte nofkë?

PË. Luta.

PY. Kush i caktoi komandantët e këtyre brigadave?

PË. Unë.

PY. Ku i kishte zyrat qendrore kjo brigadë? Ku e kishin qendrën brigadat, në qoftë se ka ndryshuar vendndodhja e tyre, na thuaj se si ka ndryshuar.

PË. Varësisht prej vijës së zjarri që e impondéveloppement armiku këto e ndryshonin bazat e tyre. Por, brigada 152 vendqëndrimin më së shumti e ka mbaj në Bradash; 151 në Boricë; në Zllash 153. Vendndodhja e tyre ka ndryshuar shpesh.

PY. Përafërsisht, për të cilat zona gjeografike, pra, cilat zona gjeografike kishin përgjegjësi secila nga brigadat? Cilat zona gjeografike mbulonte secila nga këto brigada?

PË. Nuk kanë qenë shumë të qarta, por vijën frontale kur folëm më herët ishte e ndarë mes brigadës 151 dhe 152. Ishte Llapashtica ku bashkoheshin të dy zonat, në të dy krahët, ndërsa në anën lindore, brigada 153 në Zllash. Nuk kanë pas territor kompakt që kemi mujt me e quajt zonë të lirë, siç i quanim në atë kohë.

PY. Përafërsisht, për sa kohë zgjati kjo zona e lirë, përreth Zllashit?

PË. Nuk jam i sigurt.
PY. Vetëm për sqarim, brigada 151 ishte në veri të Llapashticës dhe 152 në jug të Llapashticës apo e kundërta?
PË. E kundërta. Nga Majaci deri në Llapashticë ishte 151.
PY. Kujt i raportonin komandantët e brigadave?
PË. Të gjitha, të gjitha njësitë në zonën operative të Llapit raportonin në shtabin operativ të zonës që unë isha komandant.
PY. Komandantët e brigadave ishin pjesë e komandës së zonës?
PË. Po.
PY. Po komandantët e brigadave, a kishin në varësi njësite apo kompani?
PË. Mundoheshim të organizoheshim sa më mirë edhe ata kishin njësitë e veta, batalionet, kompanitë deri në toga. Mirëpo, Nuk ishin të përmbushura si ushtritë e rregullta që mund të flasim sot.
PY. Kush ishte Butashe? Ju thotë gjë ky emër?
PË. Po, ka qenë zëvendës në brigadën 151.
PY. Zona operative e Llapit, kishte polici ushtarake?
PË. Po.
PY. Çfarë niveli? Dhe kur them çfarë niveli, çfarë niveli të linjës së komandimit?
PË. Në nivel të zonës dhe në nivel të brigadave.
PY. Kujt i raportonte policia ushtarake në nivel brigade?
PË. Komandantit të brigadës dhe subordinoheshin me njësinë policore të zonës.

PY. Pra, ishin në varësi të policisë ushtarake në nivel zone, kështu?
PË. Nuk ishin në varësi; ata subordinoheshin me bashkë.
PY. Në nivel zone, kush ishte përgjegjës për policinë ushtarake?
PË. Nazif Mehmeti.
PY. Kishte nofkë?
PË. Dini.
PY. Kush e emëroi?
PË. Unë me shtabin tim.
PY. A ishte anëtar i komandës së zonës?
PË. Jo.
PY. Kujt i raportonte?
PË. Komandës së zonës, shefit të shtabit, mua dhe zëvendësit të shtabit të zonës operative.
PY. Çfarë detyrash kishte njësiti i Nazif Mehmetit?
PË. Për ruajtjen dhe kujdesjen ndaj objekteve dhe mirëmbajtjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, njësitet e Ushtrës Çlirimtare të Kosovës.
PY. Këtu bëhej fjalë edhe për ruajtjen e objekteve të ndalimit në bazat e UÇK-së?
PË. Po edhe ato.
PY. Po detyra të shoqërimit i kishin për personat, për shembull, që vinin për të vizituar zonën, kishin për detyrë t'i shoqëronin?

PË. Kanë mujt t'i bojnë edhe ato detyra.
PY. Polica ushtarake, kur u krijua në zonën e Llapit?
PË. Të gjitha njësitet janë shku krahas edhe vitet dikun në mesin e vitit '98 ka fillue funksionimi edhe i policisë.
PY. Bëhet fjalë për verën e '98-s, korrik, për shembull?
PË. Ka mujt me konë edhe ma herët. Nuk më kujtohet momenti i saktë.
PY. Por ekzistonin në kohën kur u bazua, u vendosët ju në Bajgore, ishin në fuqi apo ishin ekzistonin?
PË. Po, besoj që ishte në themelimin atëherë.
PY. Për cilin, në cilën periudhë kohore ishte shtabi i vendosur në Bajgore?
PË. Mendoj nga korriku deri mes të shtatorit. Ose fundi i qershorit, s'po di.
PY. Kishit marrë ndonjë udhëzim ju për të themeluar njësitit e policisë ushtarake?
PË. Nuk më kujtohet udhëzimet. Por e di se me ardhjen e Nuredin Ibishit ai ishte, kishte njohje pedagogjike për policinë mirë. Dhe kontaktet me njerëz sikurse z. Nuredin Ibishi kemi vendos që të marrim një numër të konsiderueshëm të ish-policëve të Kosovës që ishin larguar nga puna me forcë, që t'i pranonim dhe punët e rëndësishme të policisë t'i kryenin ata.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja të përdorja një deklaratë të mëparshme për të ndihmuar

dëshmitarin në kujtesën. Për të rifreskuar kujtesën.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca për palët është Pjesa 9, faqja 7.

PY. Ju kanë bërë një pyetje këtu:

"Ishte udhëzim i shtabit të përgjithshëm që të themelohej njësiti i policisë ushtarake?".

Dhe ju jeni përgjigjur:

"Po".

Kështu, është e saktë? Pra, ka qenë udhëzim i shtabit të përgjithshëm për të krijuar njësitet e policisë ushtarake?

PË. Jam i sigurt që udhëzimi ka qenë pasi që ne kemi vu në funksion policinë ushtarake.

PY. Pra, kishte udhëzim, po?

PË. Me siguri udhëzimi ka ardhë më vonë, kur është vendos shefi i shtabit, kur ka fillu me u organizu Ushtria Çlirimtare e Kosovës në nivel të vendit më mirë. Por ne kishim filluar më herët funksionalizimin e njësiteve të policisë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

PY. E kuptoj çfarë doni të thoni për periudhën, por përgjigja juaj e pyetjes sime është po? Pra, pyetja kur ju thashë, ku ju pyeta në qoftë se ju po thoni që ka pasur udhëzim nga shtabi i përgjithshëm për krijimin e policisë ushtarake.

Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj se është bërë pyetja dhe

përgjigja ka qenë e qartë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet. Dëshmitari mund t'i përgjigjet pyetjes.

DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ka pas udhëzim, po them, por pavarësisht udhëzimit ne kemi filluar organizimin e policisë më herët.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

PY. Policia ushtarake me uniforma ishte?

PË. Po, ka qenë. Varësisht prej kushteve qysh kena mujt me i gjet. Ne në fillim edhe vet s'kemi pas uniforma, por me kalimin e kohës kanë ndodh edhe uniforma, i kemi qep, kemi pas.

PY. Çfarë vishnin?

PË. Çfarëdo që kanë mujt me i bo, por orientimi ka qenë nga ngjyra e zezë ose teget, si e quajmë ne.

PY. Kishte njësi speciale, njësite të tjera speciale që vepronin në zonën e Llapit?

PË. Po. Kanë qenë njësia speciale pranë zonës dhe njësitë speciale pranë brigadave. Por të gjitha këto ishin në themelim. Nuk kanë qenë plotësisht të organizuara për --

PY. Si e kishin titullin këto njësite?

PË. Njësi speciale. Për shembull, njësia speciale pranë zonës që unë i kam njoh më mirë, i kam pas më afër. Ka pas edhe shifra numër 106 më duket, shifrën e komunikimit, njësi komando e kemi quajtur, por emri është njësi speciale.

PY. Kujt i raportonte njësiti special?
PË. Shtabit operativ që udhëhiqej nga zëvendësi im dhe shefit i shtabit dhe mua.
PY. Kush ishte komandanti i këtij njësiti special?
PË. Ka qenë, emrin e ka pas Sabit, tash s'po më kujtohet mbiemri. E kemi quajt me pseudonimin "Iliri". Nuk jeton më.
PY. Thatë që ka pasur dhe njësit special në nivel brigade. Çfarë njësiti ishte ky?
PË. E dinë brigadat më tepër, por kanë qenë të udhëzuara dhe unë besoj që kanë funksionuar njësitë speciale, njësitë për ndërhyrje të shpejtë, për ndihmë të njësiteve të tjera e kështu me radhë.
PY. Do jem më konkrete, ju kujtohet njësiti BIA?
PË. Po.
PY. Çdo me thënë BIA?
PË. Është përmbledhje e tre emrave të rënë dëshmorë: Bahri, Ilir, Agron.
PY. Në cilat zona operonte ky njësit?
PË. Kryesisht në zonat e Prishtinës, në qytet në Prishtinë, por edhe në fshatrat e Prishtinës.
PY. Kur u formua, kur u themelua ky njësit?
PË. Këta kanë qenë më herët themeluar, por me marrëveshjen që e kemi bërë me LKÇK-më që e thamë më herët, janë pranuar si njësi e veçantë e tyre.
PY. Kujt i raportonte ky njësit?

PË. Kanë mujt t'i raportojnë edhe zonës operative, por natyra e punës së tyre, ata kanë qenë ndërmjet nesh dhe LKÇK-së. Ata kanë pas raporte edhe me Brigadën 153.
PY. I raportonin si Brigadës 153, si shtabit të komandës?
PË. Nuk më kujtohet tash si ka qenë, por unë më shumë njohjen e kësaj njësie e kam pas përmes z. Fatmir Humolli. Këta kanë qenë njësi që kanë operue ma shumë për grumbullimin e të mirave për luftën e Ushtrisë Çlirimtare ë Kosovës, siç thuhej barnat, pos gjërave të tjera që me lehtësi munden me hy në Prishtinë edhe me dalë.
PY. Ku e kishte bazën njësiti?
PË. Ata më shumë kanë qëndruar në Prishtinë, kur e di unë, por kanë nëpër fshatrat e Gollakut, kudo kanë mund me qëndrue. Nuk kanë noj vend specifik që ata kanë pas.
PY. Kush ishte komandanti i atij njësiti?
PË. Sali Mustafa.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shoh orën, kështu që nëse jeni dakord është një momenti i përshtatshëm për ta mbyllur për sot.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Zotërinj, do e mbyllim seancën për sot; do fillojmë nesër përsëri në orën 09.00. Faleminderit që ishit me ne sot.

Sekretarja e Seancës do t'ju nxjerrë nga salla e gjyqit. Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në seancë publike. Do ta mbyllim seancën këtu. Do të rifillojmë nesër përsëri në orën 09.00.

--- Seanca mbyllet në orën 16.02